

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik , Departmenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjyques Shabi Idrizi dhe Sek. Juridike, Shpresa Hoxha, në lëndën penale të akuzuarit [REDAKTUE] etj nga f. [REDAKTUE]-k-Kaçanik ,të akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje në bashkryrje nga nenin 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokuroris shtetore në Ferizaj PP/II.nr. 820-1/14 të dates 19.02.2015 pas mbajtjes së shqyrimit fillestar gjyqësorë oral dhe të hapur më dt. 16.12.2016 në prezencë të Prokurorit shtetërorë Agim Kuka dhe të akuzuarit [REDAKTUE] dhe( në munges të akuzuarëve tjerë që iu është veçuar proceduar) muar dhe të njejtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

[REDAKTUE], nga i ati, [REDAKTUE] dhe nëna [REDAKTUE], e gjinisë [REDAKTUE] i lindur më dt. [REDAKTUE] në Gjilan, me vendbanim në fshatin [REDAKTUE] K-Kaçanik,i martuar, prind i Ifëmije ,ka te kryer shkollën fillore,i gjendjes së mesme ekonomike,shqiptar ,nënshtetas i Kosovës me nr personal [REDAKTUE] pa gjykuar më parë mbrohet në liri.

### ËSHTË FAJTOR

S me dt.10 mars 2014, rreth orës 01.30.min., në fshatin Doganaj-Kaçanik, me qellim të përvetsimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë se luajtshme tëtjetrit, kishin shkuar afër ambulancës së këtij fhsahti dhe nga kamioni i markës " Mercedes" me ngjyrë portokalli, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUE] kishin vjedhur 60 lira naftë

Me ketë veprim në bashkryrje kreu veprën penale vjedhje nga nenin 325 par. 1 lidhur me nenin 31të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 3, 41, 46,50, 51,75 ,76të KPK-së dhe nenit 365 dhe 453 dhe 463 të KPPK-së i shqipton

### DENIM ME GJOBË DHE KUSHT

Ashtu që të akuzuarit [REDAKTUE] , i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë), ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 .00 € të cilët nuk do të ekzekutohen po që se në afat prej 1 viti( koha e verifikimit) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në të kundërtën gjykata do i revokoj dënimin me kusht si dhe e dënim me gjobë në shumë prej 200 .00 € e cila do paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Udhëzohet i dëmtuari që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 50,00 €.

### A r s y e t i m

PTH- nga Ferizaji, me aktin akuzues PP/II.nr. 820-1/14 të dates 19.02.215 të akuzuarin [REDACTED] nga f. [REDACTED]-Kaçanik e ka akuzuar për shkak veprës penale vjedhje në bashkryrje nga nenin 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht për hir të efikasitetit dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 36 të KPPK-së ka berë veçimin e procedurës penale ndaj të akuzuarëve tjerë, pasi ka mare mendimit e prokurorit dhe të akuzuarit.

Në shqyrtimin fillestar-gjyqësor Prokurori shtetëror pranë PTH-Ferizajit Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDACTED] ta shpall fajtorë për veprën penale që akuzohet dhe të i shqiptoj denitor sipas ligjit.

I akuzuari [REDACTED], në mbrotjen e tij në shqyrtimin fillestar në tërsi e ka pranuar kryerjen e veprës penale që i vehet në barrë sipas aktit akuzues dhe njihenit eshtë penduar për këtë vepër penale, dhe propozon që gjykatës të ia shqipton një denitor sa më të butë.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale që i vehet në barrë dhe eshtë e bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbështetur në nenin 248 të KPPK-së edhe në faktet dhe provat që përmban aktakuza por edhe ne shkresat e lendës, ka gjetur se janë përbushur kushtet ligjore nga nenin 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqësore e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera.

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje nga nenin 325 par. 1 të KPRK-së, për të cilën vepër i akuzuari eshtë penalishtë përgjegjëse dhe eshtë ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga nenin 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë përbazë pranimin e fajit nga i akuzuari, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedures si dhe në shqyrtimin fillestar, kurse përbazë përllojin dhe lartsin e denimit ka marrë parasysh se eshtë hera e pare që bie ndesh me ligjin, kurse rrethane renduse faktin se kjo dukuri eshtë mjaft e përhapur.

Gjykata eshtë e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit eshtë në harmoni me shkallën e perjegjësisë penale të tij dhe peshën e veprës penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit, do arrihet qëllimi i denimit i

paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues ndaj të akuzuarit, efekt preventiv ndaj të tjerëve për moskryerjen e një veprimi I cili është I sanksionuar dhe I denushëm si dhe reagimin e shoqrisë ndaj një veprimi të tillë të ndaluar dhe të ndëshkushëm me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures është i mbshtetur në dispozitën e nenit 453 të, KPPK-së ,

Vendimi mbi udhzimin e të dëmtuarës në contest civil është i mbshtetur në dispozitën e nenit 463 të, KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE- Dega në Kaçanik

P. nr. 76/15 Me dt.16.12.2016

Sek. Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,  
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE ;Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa dhe dënim me gjobë në shumë prej 150.00 € në afat prej 15 ditësh nga ditë e pranimit. Ankesa do të bëhet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, permes kësaj Gjykate.

